

VENDIM
Nr.673, datë 15.10.2004

PËR SHPALLJE DITË ZIE KOMBËTARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 4 të ligjit nr.8926, datë 22.7.2002 "Për formën dhe përmasat e flamurit kombëtar, përmbajtjen e himnit kombëtar, formën dhe përmasat e stemës së Republikës të Shqipërisë dhe mënyrën e përdorimit të tyre", me propozimin e Zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen ditë zie kombëtare të ditës së premte, datë 15.10.2004, në nderim të viktimave, të aksidentit tragjik të datës 14.10.2004, në Urën e Bicajve, në afërsi të Fushë-Arrëzit.
 2. Në të gjitha institucionet shtetërore dhe publike, flamuri kombëtar të ulet në gjysmë shtize. Gjithashtu, në orën 12⁰⁰ të ndërpritet çdo veprimtari dhe të mbahen tri minuta heshtje, në nderim të viktimave.
 3. Të gjitha veprimtaritë artistike, kulturore dhe sportive, të planifikuara për këtë ditë, të pezullohen dhe të shtyhen për një datë të mëvonshme.
 4. Ftohen të gjitha kanalet radiotelevizive, publike dhe private, të transmetojnë muzikë funebre.
 5. Ftohen të gjitha institucionet fetare të kryejnë shërbesa, në kujtim të viktimave.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano